



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

**P.nr.820/2018**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunatoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.... R....nga fshatiH....Komuna e P...., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoqe nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1441/2018 të datës 13.09.2018, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 26.07.2023, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit: B... R..., nga babai A... nëna R..., e lindur S..., i lindur me datë ....., në Gjilan, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i SH... në adresë ....., shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

### **S E P S E**

Me datë 13.09.2018, rreth orës 00:30 në fshatin Livoq i Epërm, Komuna e Gjilanit afër pendës Policia Regjionale gjatë një plani operativ ka ndaluar të pandehurin dhe gjatë kontrollimit, në xhep i kanë gjetur një qese të vogël substancë narkotike e cila në bazë të testit fushor, substanca narkotike ka rezultuar e llojit “Marihuanë” me peshë 1.8 gram, e cila substancë sekuestrohet nga e policisë me çka i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancën narkotike.

-Me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoqe nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

### **DENIM ME GJOBË**

Ashtu që i pandehuri B.... R....dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **400 (katërqind-euro) €**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në 3(tri) këste mujore nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€(njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

**KONFISKOHET**- substanca narkotike e llojit “ Marihuanë”konform nenit 269 paragrafi 3 të KPP-së.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, si dhe 20 euro per kompenzimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

**Prokuroria Themelore në Gjilan**,Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1441/2018 të datës 13.09.2018, ndaj të pandehurit B.... R....nga fshati H....Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 26.07.2023, i cili është sjellur sipas urdhërersës P.nr. 820/2019 e datës 20.02.2019, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, është deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale.

Prokurori i shtetit gjatë seancës fillestare ka bërë përmirsimin e aktakuzës sa i përket kualifikimit juridik dhe atë në vend të nenit 275 paragrafi 2 i KRPK-së duhet të jetë neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së.

#### 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale konform nenit 242 paragrafi 1 i KPRK-së, për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se e pandehura nuk ka qenë e detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

#### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehuri B.... R....nga fshatiH....Komuna e Prishtinës, ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoqe nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së -së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës se të pandehurit, e ka shpallur fajtor të pandehurin, i cili ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoqe nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtit janë dhe penalisht përgjegjës.Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 2 të KPRK-së, konsiderohet:

2. Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoqe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

#### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurit B.... R....duhet ti shqiptohet dënimi me gjobë ne shumen prej 400(katërqindë) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në 2(dy) këste mujore, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Mirëpo nëse eventualisht e pandehura nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit,dënimin me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgimi, ose në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurës, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim është fakti se e pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, e se e njëjti i ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.

Ndërsa, rrethanë rënduese gjykata ka marr parasysh veprën e kryer dhe rrezikshmerinë shoqrore ngase keto vepra penale tani janë në rritje .

#### 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se dënimi me gjobë ne shumen prej 400(katërqindë)euro,konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë

rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konform nenit 269.3 të KPP-së, substanca narkotike e llojit “ Marihuanë” me peshë 1.8 gram- konfiskohet.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurës, gjykata, duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurën t’u detyrojë për t’i paguar shpenzimet e procedurës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 820/2018, më 26.07.2023**

**Bashkpunëtorë Profesionale,**  
Vlora Selmani-Rahimi

**Gjyqtari,**  
Veli KRYEZIU

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli:

## **A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit: B... R..., nga babai Avni nëna Rexhipe, e lindur Spahiu, i lindur me datë 23.04.1989, në Gjilan, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i SHBA-së në adresë 220Norwud Dr. Granit Shoals TX 78654, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR S E P S E**

Me datë 13.09.2018, rreth orës 00:30 në fshatin Livoq i Epërm, Komuna e Gjilanit afër pendës Policia Regjionale gjatë një plani operativ ka ndaluar të pandehurin dhe gjatë kontrollimit, në xhep i kanë gjetur një qese të vogël substancë narkotike e cila në bazë të testit fushor, substanca narkotike ka rezultuar e llojit “Marihuanë” me peshë 1.8 gram, e cila substancë sekuestrohet nga e policisë me çka i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancën narkotike.

-Me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoqe nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

### **DENIM ME GJOBË**

Ashtu që i pandehuri B.... R....dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **400 (katërqind-euro) €**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në 3(tri) këste mujore nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€(njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

KONFISKOHET- substanca narkotike e llojit “Marihuanë”konform nenit 269 paragrafi 3 të KPP-së.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, si dhe 20 euro per kompenzimin e viktimave te krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V ë r t e t o j n ë

Zyrtarja Ligjore,

G j y k a t ë s i